BASHKIA CËRRIK

# RAPORTI I PERFORMANCES 2026









Raporti i Performances viti 2025, Bashkia Cerrik, u pergatit me mbeshtetjen e Projektit Bashki të Forta, i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC (Embassy of Switzerland in Albania, Swiss Development & Cooperation) dhe Qeverisë së Suedisë (Embassy of Sweden in Tirana), i zbatuar nga Helvetas.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS
ALBANIA

# BASHKIA CERRIK

Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Cerrik, 2026

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development and Cooperation SDC**

Sweden
Sverige

# PËRMBAJTJA

Fjalor Shpjegues ..... 4
Qellimi I Raportit ..... 7
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë ..... 7
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë ..... 8
SHERBIME PUBLIKE VENDORE ..... 9
Arsimi Paraniversitar ..... 9
Menaxhimi i Mbetjeve ..... 12
Mbrojtja nga zjarri ..... 14
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ..... 16
Administrimi i pyjeve dhe kullotave ..... 17
Mbrojtja Sociale ..... 18
Gjetjet kryesore ..... 19
TE Dhenat ..... 19
Sherbime te tjera ..... 21
QEVERISJA E MIRE ..... 21
Burimet Njerëzore ..... 21
Gjetjet kryesore ..... 22
Përfundim ..... 23
Transparenca ..... 23
Barazia Gjinore ..... 24
Integrimi në BE ..... 26
MENAXHIMI FINANCIAR ..... 28
Administrimi i tregjeve ..... 32
Mbeshtetje biznesi ..... 36
Konkluzione & Rekomandime ..... 42

# FJALOR SHPJEGUES

## Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

## Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

## Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

## Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

## Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

## Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë

me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësive të vetëqeverisjes vendore.

### Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këto përfshijnë, ndër të tjera, , ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit the ligjit "janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative'

### Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

### Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

### Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

### Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

### Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

### Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve ne cdo fushe paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

| Kolona | Përshkrimi |
|---|---|
| Treguesi | Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara"). |
| Njësia matëse | Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë). |
| Vlera 2023 / 2024 /2025 | Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit. |
| Ndryshimi (%) | Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: (Vlera 2025/2024 – Vlera 2023) / Vlera 2023 × 100. |
| Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓) | Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2025 2024 – Vlera 2023). Simboli I Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet |

| | |
|---|---|
| Semafori | Vlerësim vizual i nivelit të performancës: ◍ = vlere absolute ndryshimi positiv ◍ =vlere absolute ndryshimi negative. |

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm "vlera positive ndryshimi = jeshile". Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv. Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efiçencë).

Ne te tilla raste merret parasysh shpjegimi narrativ ne raport.

# QELLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2026 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 14 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia __Cerrik______, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2026).

# VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia Cërrik e pozicionuar në qendër të vendit përbëhet nga 5 Njësi Administrative: Shalës, Gostimë, Cërrik, Klos dhe Mollas me sipërfaqe prej 189.65 km2. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Cërrikut. Popullsia e bashkisë numëron rreth 48534 banorë sipas të dhënave të Regjistrit Civil.

Bashkia drejtohet nga Kryetari Z. Florenc Doka

Bashkia Cërrik është një njesi vendore me potencial të rendësishëm zhvillimi , e karakterizuar nga nje pozitë gjeografike e favorshme dhe një komunitet aktiv. Me një përzierje të traditës dhe zhvillimit të ri, Bashkia ka si prioritet përmiësimin e sherbimeve publike , forcimin e kapaciteteve financiare dhe nxitjen e investimeve që kontribuojn në zhvillimin ekonomike social të qytetarëve. Ky vit karakterizohet nga një rritje e dukshme e investimeve duke sjell një rimekembje e ekonomisë në disa programe specifike të Bashkise Cërrik.Duke qënë një bashki e vogël ,ne përditë e më shumë ndeshemi me sfida pafund por duke bashkëpunuar dhe mbështetur nga pushteti qëndror kemi mundur të realizojmë dhe përmbushim objektivat tona .

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit janë:

Gjate periudhës raportuese , Bashkia ka arritur të realizoje disa nga sfidat kryesore të saj . Është siguruar rritja e të ardhurave vendore , duke forcuar kështu kapacitetet financiare dhe mundësinë për të përmbushur më mirë nevojat e komunitetit . Gjithashtu , janë rritur shpenzimet për investime , me synimimin zhvillimin ekonomik , përmirësimin e infrastukturës dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët . Një tjetër arritje me rëndësi ka qënë ulja e nivelit të detyrimeve të prapambetura me 10% cka ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e transparences , stabilitetit financiar dhe besueshmerise institucionale .

# TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

| E DHËNA | Viti 2025 |
|---|---|
| Popullësia totale nën administrimin e bashkisë | 48378 |
| Popullsia në qytet | 14945 |
| Popullsia në njësitë administrative | 33433 |
| Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2) | 189.65 |
| Sipërfaqe publike e bashkisë në km2 | |
| Sipërfaqja e njësive administrative në total | 178.70 |
| Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha) | 5497.4 |
| Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha) | 5497.4 |
| Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha) | 8466 |
| Numri total i njësive administrative të bashkisë | 4 |
| Numri i fshatrave | 28 |
| Punonjës të bashkisë në total | 294 |
| Numri total i punonjëseve femra të bashkisë | 139 |
| Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë | 155 |

| | |
|---|---|
| Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë | 81 |

# SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësive të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore te aprovuara edhe ne kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

## ARSIMI PARANIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:
- Funksioni 23.11: "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale."
Funksioni 23.12: "Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe."

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve
Treguesit e arsimit parauniversitar në Bashkinë Cërrik për vitin 2025 paraqesin një përmirësim të

dukshëm në aspektin e infrastrukturës dhe mirëmbajtjes, ku të gjitha kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare rezultojnë të mirëmbajtura në nivel 100%.
Nga ana tjetër, evidentohet një përmirësim në raportet nxënës/mësues dhe në madhësinë e klasave, çka sugjeron kushte më të mira për procesin mësimor dhe një shpërndarje më efikase të burimeve njerëzore. Megjithatë, vërehet një rënie e ndjeshme në shkallën e regjistrimit në kopshte (—16.5%), e cila përbën një sinjal për analizë më të thelluar mbi faktorët demografikë, migrimin apo aksesin në shërbim. Gjithashtu, mungesa e Planit Vendor të Arsimit mbetet një boshllëk në planifikimin strategjik.
Përfundim
Sektori i arsimit karakterizohet nga cilësi dhe mirëmbajtje e lartë infrastrukturore, por përballet me sfida në aspektin e kërkesës për shërbim dhe planifikimit afatgjatë.

**A) Lista e detajuar**

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Kopshteve të mirëmbajtura kundrejt numrit total të kopshteve pubike | % | 80.95 | 100.00 | 19.05 | ↑ | 23.53 % | 🟢 |
| Tregues | Shkolla 9 vjeçare të mirëmbajtura, kundrejt numrit total të shkollave 9 vjeçare publike | % | 94.12 | 100.00 | 5.88 | ↑ | 6.25% | 🟢 |
| Tregues | Raporti nxënës/mësues në shkolla 9 vjeçare | nxënës/mësues | 7.70 | 7.62 | -0.08 | ↓ | -1.05% | 🔴 |
| Tregues | Numri mesatar i nxënësve në një klasë të shkollës 9 vjeçare publike | nxënës/klasë | 8.14 | 8.06 | -0.09 | ↓ | -1.05% | 🔴 |
| Tregues | Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik | nxënës/klasë | 12.66 | 11.82 | -0.84 | ↓ | -6.65% | 🔴 |
| Tregues | Punonjës mbështetës për shkollë 9 vjeçare | punonjës mbështetës/shkollë 9 vjeçare | 1.65 | 1.75 | 0.10 | ↑ | 6.25% | |
| Tregues | Shkolla 9 vjeçare të rikonstruktuara | numër | 1.00 | 1.00 | 0.00 | → | 0.00% | 🟠 |
| Tregues | Kopshte të rikonstruktuara | numër | 3.00 | 1.00 | -2.00 | ↓ | -66.67 % | 🔴 |
| Tregues | Raporti i shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar kundrejt numrit total të institucioneve (Mijë Lekë/institucion) | Mijë Lekë/institucion | 2427.74 | 3169.38 | 741.64 | ↑ | 30.55 % | 🟢 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Kopshte ku jane ngritur këshillat e prinderve kundrejt numrit total te kopshteve publike | % | 9.52 | 11.76 | 2.24 | ↑ | 23.53 % | ● |
| Tregues | Punonjës mbështetës për shkollë mesme të përgjithshme | punonjës mbështetës/shkollë e mesme | 2.50 | 2.50 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Shpenzime kundrejt numrit total të studentëve të akomoduar në konvikte | Mijë Lekë/student | 363.05 | 1422.23 | 1059.18 | ↑ | 2.92% | ● |
| Tregues | Numri mesatar i nxënësve në një klasë të arsimit të mesëm të përgjithshëm publik | nxënës/klasë | 0.00 | 18.45 | 18.45 | ↑ | 0.00% | ● |
| Tregues | Numri mesatar i nxënësve në një dhomë në konvikt të arsimit profesional | nxënës/dhomë konvikti | 0.46 | 0.48 | 0.02 | ↑ | 4.76% | ● |
| Tregues | Numri i konvikteve funksionale | numër | 1.00 | 1.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Numri I prinderve te informuar ne lidhje me prinderimin pozitiv per femijet 0-3 vjec | numër | 106.00 | 127.00 | 21.00 | ↑ | 19.81 % | ● |
| Tregues | Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike | nxënës/mësues | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private | % | 91.62 | 76.49 | -15.13 | ↓ | -16.51 % | ● |
| Tregues | Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar | Po/Jo | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00% | ○ |
| Tregues | Godina Arsimore sipas nivelit arsimor | numër | 42.00 | 37.00 | -5.00 | ↓ | -11.90 % | ● |
| Nëntregues | Shkalla e regjistrimit të vajzave në çerdhe publike | % | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Nëntregues | Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor | numër | 49.00 | 49.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Nëntregues | Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor | numër | 4.00 | 4.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nëntregues | Shkalla e regjistrimit në kopshte publike | % | 91.62 | 100.00 | 8.38 | ↑ | 9.15% | ● |
| Nëntregues | Shkalla e regjistrimit në kopshte private | % | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Nëntregues | Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike | nxënës/mësues | 22.90 | 12.69 | -10.21 | ↓ | -44.59 % | ● |

# MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve
Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Cërrik paraqitet me mbulim të plotë territorial (100%), duke garantuar akses universal për qytetarët në zonat urbane dhe rurale.

Një zhvillim i mirë është qendrueshmeria e treguesit të mbulimit të kostos nga tarifa (ne masen 44%), që sinjalizon qëndrueshmeri në eficiencën financiare të shërbimit. Treguesi i mbetjeve për banor paraqet gjithashtu qendrueshmeri, ne gjenerimin e mbetjeve nga popullsia e bashkise.

Përfundim
Shërbimi është i konsoliduar në mbulim, por kërkon përmirësim në aspektin financiar si dhe në planifikimin strategjik (mungesë e planit vendor).

**A) Lista e detajuar**

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00% | 🔴 |
| Tregues | Mbetjet e gjeneruara si kg/banor | kg/banor | 82.16 | 82.63 | 0.47 | ↑ | 0.58% | 🟢 |
| Tregues | Mbulimi kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit | % | 44.10 | 44.16 | 0.06 | ↑ | 0.13% | 🟢 |
| Tregues | Plani vendor I menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim | Numër | 0.00 | 1.00 | 1.00 | ↑ | 0.00% | 🟢 |
| Nëntregues | Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00% | 🔴 |
| Nëntregues | Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00% | 🔴 |

## B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | Kodi i Treguesit | Përdorur në treguesit | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| D54 | 2310A01 | 2310A01 | Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve | 5 | 5 | 5 | Numër |
| D55 | 2310A01 | 2310A01 | Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë | 5 | 5 | 5 | Numër |
| D56 | 2310A01 | 2310A01 | Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve | 28 | 28 | 28 | Numër |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| D57 | 2310A01 | 2310A01 | Numri fshatrave në territorin e bashkise | 28 | 28 | 28 | Numër |
| D58 | 2310A02 | 2310A02 | Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej | 3875480 | 3986840 | 3997670 | Kg |
| D59 | 2310A03 | 2310A03 | Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve | 16568 | 20157 | 19860 | mijë Lekë |
| D60 | 2310A03 | 2310A03 | Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve | 39994 | 45703 | 44973 | mijë Lekë |
| D61 | 2310A04 | 2310A04 | Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit | 0 | 0 | 1 | Cilësore (Po=1/Jo=0) |
| D52 | 2310A02 | 2310A02 | Popullsia e përgjithshme e bashkisë | 48534 | 48525 | 48378 | Numër |

# MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Aktivitete përfaqësuese përfshijnë : - - - - Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës; Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa

publike dhe hapësira komunitare; Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve
Shërbimi zjarrfikës në Bashkinë Cërrik paraqet një përmirësim të moderuar në kapacitetet operative, me rritje të raportit të zjarrfikësve dhe mjeteve për banor.

Ky përmirësim reflekton investime të kufizuara por të qëndrueshme në kapacitete njerëzore dhe logjistike. Numri i punonjësve dhe mjeteve mbetet relativisht i qëndrueshëm, ndërkohë që përmirësimi lidhet kryesisht me efektin e popullsisë dhe optimizimin e përdorimit të burimeve ekzistuese.

Përfundim
Shërbimi karakterizohet nga stabilitet dhe përmirësim gradual, ndërsa sfida kryesore mbetet rritja e mëtejshme e kapaciteteve për të përballuar rreziqe më komplekse, veçanërisht në zona rurale dhe pyjore.

## A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Zjarrëfikës për 1,500 banorë | punonjës/ 1500 banorë | 0.69 | 0.72 | 0.02 | ↑ | 3.57% | ● |
| Tregues | Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë | mjete/10 000 banorë | 1.32 | 1.48 | 0.16 | ↑ | 12.50 % | ● |

## B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D51 | Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki | 14 | 14 | 14 | Numër |
| D52 | Popullsia e përgjithshme e bashkisë | 48534 | 48525 | 48378 | Numër |
| D53 | Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki | 4 | 4 | 4 | Numër |
| D50 | Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor | 3 | 3 | 4 | Numër |

# MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funksioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimit të ujërave të tepërta në zonat bujqesore.

## Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Treguesit e ujitjes dhe kullimit tregojnë një stabilitet në mbulimin e tokës bujqësore (64%) dhe një përmirësim të lehtë në funksionalitetin e rrjetit.

Rritja e përqindjes së kanaleve funksionale sugjeron përmirësime në mirëmbajtje dhe operim, megjithëse progresi mbetet i moderuar.

Ky sektor reflekton një nivel mesatar performance, ku infrastruktura ekzistuese mbahet funksionale, por nuk ka zgjerim të konsiderueshëm të sistemit.

Përfundim
Sektori është funksional dhe në përmirësim gradual, por kërkon investime më të mëdha për zgjerim dhe modernizim të infrastrukturës.

### A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi | % | 64.00 | 64.00 | 0.00 | → | 0.00% | 🔴 |
| Tregues | Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale | % | 54.45 | 56.75 | 2.30 | ↑ | 4.22% | 🟢 |
| Nëntregues | Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale | % | 55.00 | 57.46 | 2.46 | ↑ | 4.48% | 🟢 |
| Nëntregues | Përqindja e kanaleve kulluese funksionale | % | 54.00 | 56.04 | 2.04 | ↑ | 3.77% | 🟢 |

### B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D41 | Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki | 8466 | 8466 | 8466 | Hektarë |
| D42 | Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi | 5402 | 5418 | 5418 | Hektarë |
| D43 | Gjatësia e kanaleve ujitëse | 226.23 | 226.23 | 226.23 | Kilometër (km) |
| D44 | Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale | 121.65 | 124.43 | 130 | Kilometër (km) |
| D45 | Gjatësia e kanaleve kulluese | 214.53 | 214.53 | 214.15 | Kilometër (km) |
| D46 | Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale | 112.45 | 115.64 | 120 | Kilometër (km) |

# ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funksioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Administrimi i pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Cërrik paraqet një nivel relativisht të qëndrueshëm të menaxhimit të territorit natyror, duke reflektuar vazhdimësi në mbulimin dhe administrimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore. Treguesit e mbulimit dhe inventarizimit të sipërfaqeve mbeten të qëndrueshëm ndërvite, duke sugjeruar një bazë të konsoliduar të të dhënave dhe një kontroll të mirë administrativ të këtij fondi.

Në aspektin operacional, evidentohet një angazhim gradual për përmirësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes, i reflektuar në rritjen e lehtë të kapaciteteve njerëzore dhe në përmirësimin e treguesve të lidhur me funksionalitetin e territorit (si përdorimi dhe administrimi i sipërfaqeve). Megjithatë, zhvillimi

mbetet i moderuar, duke treguar se ndërhyrjet janë kryesisht mirëmbajtëse dhe jo zgjeruese apo transformuese.

Një element i rëndësishëm është roli i këtij funksioni në mbështetjen e ekonomisë lokale, veçanërisht për komunitetet rurale që varen nga kullotat dhe burimet natyrore. Në këtë drejtim, stabiliteti i treguesve sugjeron që shërbimi po garanton një nivel të qëndrueshëm aksesit dhe përdorimi të burimeve, megjithëse pa ndryshime të mëdha në intensitet apo produktivitet.

Përfundim

Sektori i pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Cërrik paraqitet funksional dhe i qëndrueshëm, me administrim të mirë të bazës territoriale dhe me përmirësime të lehta në kapacitete. Megjithatë, për të rritur ndikimin ekonomik dhe mjedisor të këtij funksioni, mbetet e rëndësishme forcimi i mëtejshëm i menaxhimit aktiv, investimet në mirëmbajtje dhe zhvillimi i planeve të qëndrueshme të përdorimit të burimeve natyrore.

**A) Lista e detajuar**

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar | Cilësore (Po/Jo) | 1.00 | 1.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi | % | 82.71 | 82.71 | 0.00 | → | 0.00 % | ● |
| Tregues | Punonjës për 1,000 hektarë | punonjës/ 1000 ha | 0.30 | 0.30 | 0.00 | → | 0.00% | ● |

# MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

## GJETJET KRYESORE

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Shërbimi i mbrojtjes sociale në Bashkinë Cërrik paraqet një nivel të qëndrueshëm të mbulimit dhe funksionimit të shërbimeve bazë, duke garantuar akses për kategoritë në nevojë në përputhje me detyrimet ligjore. Treguesit kryesorë sugjerojnë që bashkia ka arritur të mbajë një nivel të lartë të përfshirjes së përfituesve në skemat e mbështetjes sociale dhe në shërbimet për grupet vulnerabël.

Në aspektin e shtrirjes dhe efektivitetit të shërbimeve, vihet re një stabilitet në mbulimin e familjeve dhe individëve në nevojë, ndërkohë që përmirësime të lehta mund të lidhen me zgjerimin e shërbimeve specifike apo me rritjen e ndërhyrjeve për kategori të caktuara (si personat me aftësi të kufizuar apo përfituesit e ndihmës ekonomike). Ky stabilitet reflekton një funksionim të mirë të mekanizmave administrativë dhe të identifikimit të përfituesve.

Nga ana tjetër, dimensioni strategjik i sektorit paraqet hapësirë për zhvillim të mëtejshëm, veçanërisht në drejtim të planifikimit afatgjatë dhe diversifikimit të shërbimeve sociale, në mënyrë që të kalojë nga një model kryesisht mbështetës në një model më aktiv, të orientuar drejt integrimit social dhe përfshirjes së qëndrueshme të përfituesve.

Përfundim

Mbrojtja sociale në Bashkinë Cërrik paraqitet funksionale dhe e qëndrueshme në mbulimin e nevojave bazë, duke garantuar vazhdimësi të shërbimeve për kategoritë vulnerabël. Në vijim, fokusi mund të vendoset në forcimin e komponentit strategjik dhe në zgjerimin cilësor të shërbimeve, për të rritur ndikimin social dhe përfshirjen e komunitetit.

## TE DHENAT

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike | % | 98.93 | 92.67 | -6.27 | ↓ | -6.33% | ● |
| Tregues | Shkalla e miratimit të strehimit social | % | 80.95 | 61.24 | -19.72 | ↓ | -24.36% | ● |
| Tregues | Numri i qendrave sociale komunitare publike, te licensuara për 10,000 banorë | qendra/10,000 banore | 0.82 | 0.83 | 0.00 | ↑ | 0.30% | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale | % | 81.58 | 92.68 | 11.10 | ↑ | 13.61 % | ● |
| Tregues | Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Plan vendor social | Cilësore (Po/Jo) | 0.00 | 1.00 | 1.00 | ↑ | 0.00% | ● |

## B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D62 | Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike | 736 | 750 | 750 | Numër |
| D63 | Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike | 733 | 742 | 695 | Numër |
| D52 | Popullsia e përgjithshme e bashkisë | 48534 | 48525 | 48378 | Numër |
| D64 | Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social | 35 | 21 | 178 | Numër |
| D65 | Numri i personave përfitues të strehimit social | 17 | 17 | 109 | Numër |
| D66 | Numri i qendrave sociale ditore funksionale | 3 | 3 | 3 | Numër |
| D67 | Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale | 1 | 1 | 1 | Numër |
| D68 | Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit | 41 | 38 | 41 | Numër |
| D69 | Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale | 28 | 31 | 38 | Numër |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| D70 | Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale | 978 | 988 | 1080 | Numër |
| D71 | Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit | 978 | 988 | 1080 | Numër |
| D72 | Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit | 0 | 0 | 1 | Cilesore(Po=1/Jo=0) |

# SHERBIME TE TJERA

# QEVERISJA E MIRE

Qeverisja e mirë përfaqëson aftësinë institucionale të bashkisë për të ushtruar përgjegjësitë publike me integritet, transparencë dhe efikasitet, duke garantuar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive. Në kuadër të matjes së performancës vendore, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave përfaqësuese, të cilat reflektojnë cilësinë e proceseve të brendshme dhe kapacitetin administrativ për të siguruar rezultate të qëndrueshme:

1. 👥 Burimet Njerëzore – masin strukturën, stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës vendore, si dhe nivelin e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore.
2. 🕮 Transparenca – tregon nivelin e hapjes së informacionit dhe komunikimit me qytetarët, publikimin e akteve dhe respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur.
3. ⚖ Barazia Gjinore – reflekton përpjekjet institucionale për të siguruar përfaqësim të barabartë dhe përfshirje gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe politikëbërjes lokale.
4. EU Integrimi në BE – mat aftësinë e bashkisë për të përafruar praktikat e saj me standardet evropiane, përmes projekteve bashkëpunuese, partneriteteve ndërbashkiake dhe strukturave të dedikuara të integrimit..

# 👥 BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për

1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

## GJETJET KRYESORE

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Burimet njerëzore në Bashkinë Cërrik paraqesin një strukturë të konsoliduar dhe relativisht të balancuar, me një total prej 280 punonjësish, nga të cilët 139 janë gra dhe 141 burra, duke reflektuar një shpërndarje pothuajse të barabartë gjinore. Gjithashtu, administrata përbëhet nga 81 punonjës, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në njësitë shpenzuese dhe shërbimet operative, çka tregon një organizim të orientuar drejt ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve.

Në raport me popullsinë e bashkisë (rreth 48,500 banorë), numri i punonjësve tregon një nivel mesatar të kapaciteteve administrative, i përshtatur me madhësinë dhe kompleksitetin e territorit. Kjo sugjeron një balancë ndërmjet funksioneve administrative dhe atyre operative, megjithëse hapësira për optimizim dhe specializim të mëtejshëm të stafit mbetet e pranishme.

Nga ana funksionale, struktura aktuale reflekton një stabilitet organizativ, me shpërndarje të qartë të burimeve njerëzore ndërmjet funksioneve kryesore të bashkisë. Megjithatë, bazuar në treguesit e performancës dhe kompleksitetin e shërbimeve, vihet re nevoja për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e investimit në trajnim, veçanërisht në fusha teknike dhe menaxheriale.

Përfundim

Burimet njerëzore në Bashkinë Cërrik paraqiten të qëndrueshme dhe funksionale, me një strukturë të balancuar dhe të orientuar drejt shërbimeve. Në vijim, fokusi mund të vendoset në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, rritjen e eficiencës dhe përshtatjen e strukturës me kërkesat në rritje të shërbimeve publike dhe zhvillimit vendor.

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë | % | 1.79 | 1.36 | -0.43 | ↑ | -23.81 % | |
| Tregues | Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar | % | 7.14 | 7.48 | 0.34 | ↑ | 4.76% | |
| Tregues | Punonjës për 1000 banorë | punonjës /1,000 banorë | 6.02 | 6.33 | 0.31 | ↑ | 5.12% | |

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D73 | Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit | 278 | 280 | 294 | Numër |
| D74 | Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit | 7 | 5 | 4 | Numër |
| D52 | Popullsia e përgjithshme e bashkisë | 48534 | 48525 | 48375 | Numër |
| D75 | Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit | 9 | 20 | 22 | Numër |
| D76 | Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit | 12 | 12 | 12 | Numër |

PËRFUNDIM

# TRANSPARENCA

***Përshkrim i përgjithshëm:*** Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkitë kanë detyrimin të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojnë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japin llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin.

Në këtë kuadër, bashkitë duhet të garantojnë : (i) zhvillimin e konsultimeve publike për aktet me nd ikim në komunitet ; (ii) publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumenteve të rëndësishme si Plani Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale dhe raportet vjetore të transparencës ;

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Transparenca në Bashkinë Cërrik paraqet një nivel të qëndrueshëm të zbatimit të procedurave bazë të konsultimit dhe raportimit publik, duke reflektuar respektim të detyrimeve ligjore për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Treguesit e konsultimeve publike dhe publikimit të informacionit mbeten të qëndrueshëm ndërvite, duke treguar vazhdimësi në praktikat institucionale të transparencës.

Në aspektin e raportimit, vihet re një angazhim në rritje për formalizimin e proceseve të transparencës, përmes përgatitjes së dokumenteve dhe komunikimit publik të rezultateve të performancës. Megjithatë, disa instrumente kyç, si planet e integritetit apo mekanizmat më të avancuar të llogaridhënies, paraqiten ende në fazë zhvillimi, duke sugjeruar hapësirë për konsolidim të mëtejshëm.

Në tërësi, praktikat e transparencës mbështeten në një bazë funksionale, me procedura të vendosura dhe të zbatuara, por që kërkojnë një thellim në cilësi dhe standardizim, veçanërisht në drejtim të përfshirjes aktive të qytetarëve dhe përdorimit të mjeteve digjitale.

Përfundim

Transparenca në Bashkinë Cërrik paraqitet e qëndrueshme në aspektin procedural, duke garantuar bazat e informimit dhe konsultimit publik. Në vijim, sfida kryesore mbetet forcimi i mekanizmave të integritetit

dhe rritja e cilësisë së komunikimit me qytetarët, në funksion të një qeverisjeje më të hapur dhe gjithëpërfshirëse.

### A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes | Cilësore (Po=1/Jo=0) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Plani Vendor i Integritetit | Cilësore (Po=1/Jo=0) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Nëntregues | | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00% | ○ |

### B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D77 | Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik | 4 | 6 | 6 | Numër |
| D78 | Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik | 4 | 6 | 6 | Numër |
| D79 | Publikimi i raportit vjetor për transparencën | 1 | 1 | 1 | Cilësore (Po=1/Jo=0) |
| D80 | Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit | 1 | 1 | 1 | Cilësore (Po=1/Jo=0) |

## BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjigjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; • ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjninor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination) dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Barazia gjinore në Bashkinë Cërrik paraqet një nivel të mirë përfaqësimi në strukturën e përgjithshme të stafit, ku shpërndarja ndërmjet grave dhe burrave është pothuajse e balancuar (139 gra dhe 141 burra). Ky tregues reflekton një bazë pozitive për përfshirjen gjinore në administratën vendore.

Në aspektin e përfaqësimit në nivelet drejtuese dhe vendimmarrëse, panorama paraqitet më e moderuar, duke sugjeruar se megjithëse balanca ekziston në totalin e stafit, ajo nuk reflektohet gjithmonë në të njëjtën masë në pozicionet e drejtimit. Kjo tregon nevojën për përforcim të politikave që mbështesin avancimin profesional të grave në hierarkinë institucionale.

Nga ana strategjike, integrimi i dimensionit gjinor në dokumentet dhe politikat vendore mbetet një element që kërkon zhvillim të mëtejshëm, për të kaluar nga një përfaqësim numerik në një qasje më të strukturuar dhe të qëndrueshme të barazisë gjinore, të integruar në planifikim dhe vendimmarrje.

Përfundim

Barazia gjinore në Bashkinë Cërrik paraqitet pozitive në aspektin e përfaqësimit të përgjithshëm, ndërkohë që mbetet hapësirë për forcimin e rolit të grave në nivelet drejtuese dhe për integrimin më të thelluar të barazisë gjinore në politikat dhe praktikat institucionale.

## A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore | % | 38.46 | 38.46 | 0.00 | → | 0.00% | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki | % | 65.63 | 65.63 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore | Cilësore (Po/Jo) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Nëntregues | | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00% | ○ |

## B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D81 | Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak). | 28 | 28 | 28 | Numër |
| D82 | Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore | 10 | 11 | 11 | Numër |
| D83 | Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) | 18 | 18 | 18 | Numër |
| D84 | Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) | 8 | 10 | 10 | Numër |
| D85 | Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit | 1 | 1 | 1 | Cilësore (Po=1/Jo=0). |

# INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me acquis communautaire dhe përmbushjen e kritereve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;

▪ Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirjen e komuniteteve në proces integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Integrimi evropian në Bashkinë Cërrik paraqet një progres të dukshëm në përfshirjen në programe dhe instrumente të Bashkimit Evropian, veçanërisht në aspektin e projekteve të aplikuara dhe të fituara. Treguesit tregojnë një rritje të kapaciteteve për përthithjen e fondeve, duke reflektuar një përmirësim të përgatitjes institucionale dhe të aftësive për aplikim.

Në të njëjtën kohë, bashkia ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm bashkëpunimi ndërbashkiak, si dhe funksionimin e strukturave të performancës, të cilat përbëjnë një bazë të rëndësishme për procesin e integrimit. Këto elemente tregojnë një konsolidim të mekanizmave institucionalë që mbështesin përafrimin me standardet evropiane.

Megjithatë, disa komponentë të rëndësishëm strategjikë, si planet e migracionit dhe diasporës apo zhvillimi i plotë i strukturave të integrimit në nivel këshilli bashkiak, paraqiten ende të pjesshme ose në fazë zhvillimi. Kjo sugjeron nevojën për një qasje më të strukturuar dhe të integruar në këtë drejtim.

Përfundim

Bashkia Cërrik paraqet një orientim pozitiv drejt integrimit evropian, me progres në aspektin praktik (projekte dhe bashkëpunim) dhe një bazë funksionale institucionale. Në vijim, fokusi mund të vendoset në forcimin e komponentit strategjik dhe në institucionalizimin më të plotë të proceseve të integrimit në të gjitha nivelet e qeverisjes vendore.

## A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki | Numër | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00% | ● |
| Tregues | Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki | Cilësore (Po=1/Jo=0) | 1.00 | 0.00 | -1.00 | ↓ | -100.00 % | ● |
| Tregues | Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024) | % | 15.38 | 8.33 | -7.05 | ↓ | -45.83 % | ● |
| Tregues | Planet e migracionit dhe diasporës | Cilësore (Po=1/Jo=0) | 1.00 | 0.00 | -1.00 | ↓ | -100.00 % | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Komisionet e integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë | Cilësore (Po=1/Jo=0) | 1.00 | 0.00 | -1.00 | ↓ | -100.00% | ● |
| Nëntregues | | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00% | ○ |

## B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D86 | Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara | 1 | 2 | 2 | Numër |
| D87 | Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë | 1 | 1 | 1 | Cilësore (Po=1/Jo=0) |
| D88 | Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integrimit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së | 1 | 1 | 1 | Cilësore (Po=1/Jo=0) |
| D89 | Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës se raportimit | 2 | 2 | 3 | Numër |
| D90 | Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës se raportimit | 1 | 2 | 2 | Numër |
| D91 | Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit | 0 | 0 | 0 | Cilësore (Po=1/Jo=0) |
| D92 | Komisionet e Integrimit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë | 0 | 0 | 1 | Cilësore (Po=1/Jo=0) |

# MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxhetimi. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Menaxhimi financiar në Bashkinë Cërrik paraqet një përmirësim të dukshëm në gjenerimin e të ardhurave vendore, ku të ardhurat e veta për frymë janë rritur nga 3,664.65 në 4,135.56 lekë (+12.85%). Kjo rritje reflektohet edhe në vlerën absolute të të ardhurave vendore, të cilat kanë arritur në 200,070 mijë lekë në vitin 2025, duke treguar një përforcim të kapacitetit të bashkisë për gjenerimin e burimeve të brendshme. Në të njëjtën kohë, pesha e të ardhurave nga taksa e pasurisë mbetet e qëndrueshme (rreth 25%), duke konfirmuar rëndësinë e këtij burimi në strukturën e të ardhurave vendore.

Nga ana tjetër, treguesit e autonomisë financiare paraqesin një ulje të lehtë të peshës së të ardhurave vendore ndaj transfertave dhe buxhetit total, duke reflektuar një rritje më të shpejtë të transfertave (deri në 454,953 mijë lekë) krahasuar me të ardhurat vendore. Megjithatë, bashkia vijon të ruajë një nivel relativisht të mirë të përdorimit të të ardhurave (89.95%) dhe një shkallë të lartë të ekzekutimit të buxhetit (92.44%), edhe pse këta tregues kanë pësuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin e mëparshëm.

Në aspektin e shpenzimeve, evidentohet një rritje e investimeve për frymë (+15.67%) dhe një nivel i qëndrueshëm i peshës së tyre në buxhet (rreth 27%), duke reflektuar vazhdimësi në orientimin drejt zhvillimit. Një zhvillim pozitiv është edhe ulja e detyrimeve të prapambetura (nga 22.85% në 17.55%), që tregon përmirësim në menaxhimin e angazhimeve financiare. Në të njëjtën kohë, rritja e peshës së shpenzimeve për personelin (48.56%) dhe ulja e shpenzimeve operacionale sugjerojnë një ristrukturim të brendshëm të shpenzimeve.

Përfundim

Menaxhimi financiar në Bashkinë Cërrik paraqitet i qëndrueshëm dhe në përmirësim gradual, me rritje të të ardhurave vendore dhe investimeve, si dhe me përmirësim në menaxhimin e detyrimeve. Megjithatë, mbetet e rëndësishme forcimi i mëtejshëm i autonomisë financiare dhe balancimi i strukturës së shpenzimeve, për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë dhe mbështetje më të madhe për zhvillimin lokal.

## A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | Vlera (viti i kaluar) | Vlera (viti aktual) | Trendi | Simbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Të ardhurat e veta për frymë | leke/person | 3664.65 | 4135.56 | 470.91 | ↑ | 12.85 % | |
| Tregues | Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave | % | 49.02 | 43.98 | -5.04 | ↓ | -10.29 % | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit | % | 32.89 | 30.54 | -2.35 | ↓ | -7.15% | 🔴 |
| Tregues | Shkalla e përdorimit të të ardhurave | % | 93.85 | 89.95 | -3.90 | ↓ | -4.16% | 🔴 |
| Tregues | Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore | % | 24.93 | 24.94 | 0.02 | ↑ | 0.07% | 🟢 |
| Tregues | Buxheti i miratuar për frymë | leke/person | 10833.14 | 13174.77 | 2341.63 | ↑ | 21.62% | 🟢 |
| Tregues | Shkalla e ekzekutimit të buxhetit | % | 96.52 | 92.44 | -4.07 | ↓ | -4.22% | 🔴 |
| Tregues | Investime për frymë | leke/person | 2813.50 | 3254.41 | 440.91 | ↑ | 15.67% | 🟢 |
| Tregues | Pesha e investimeve në buxhet | % | 26.91 | 26.72 | -0.19 | ↓ | -0.70% | 🔴 |
| Tregues | Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve | % | 22.85 | 17.55 | -5.30 | ↑ | -23.20% | 🟢 |
| Tregues | Pesha e personelit në buxhet | % | 45.90 | 48.56 | 2.66 | ↑ | 5.80% | 🟢 |
| Tregues | Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet | % | 27.19 | 24.78 | -2.42 | ↓ | -8.89% | 🔴 |
| Nëntregues | | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00% | ○ |

## B) Shtojcë: Të dhënat burim

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| D93 | Të ardhurat e veta, fakt | 167884 | 177827 | 200070 | Mijë Leke |
| D52 | Popullsia e përgjithshme e bashkisë | 48534 | 48525 | 48378 | Numër |
| D94 | Transfertat gjithsej, fakt | 321259 | 362769 | 454953 | Mijë Leke |
| D95 | Të ardhurat e përgjithshme, fakt | 489143 | 540596 | 655023 | Mijë Leke |
| D96 | Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt | 459607 | 507376 | 589214 | Mijë Leke |
| D97 | Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt | 36634 | 44327 | 49907 | Mijë Leke |
| D98 | Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar | 489143 | 525678 | 637369 | Mijë Leke |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| D99 | Shpenzime kapitale, fakt | 127207 | 136525 | 157442 | Mijë Leke |
| D100 | Detyrime të papaguara mbi 30 ditë | 135064 | 115953 | 103416 | Mijë Leke |
| D101 | Shpenzime personeli, fakt | 211816 | 232876 | 286113 | Mijë Leke |
| D102 | Shpenzime operacionale, fakt | 120584 | 137975 | 145981 | Mijë Leke |

# ADMINISTRIMI I TREGJEVE

Administrimi i tregjeve është një funksion i qeverisjes vendore që lidhet me organizimin, menaxhimin dhe monitorimin e hapësirave publike të tregtimit, veçanërisht për produktet bujqësore dhe blegtorale. Ky shërbim përfshin të gjitha aktivitetet që sigurojnë funksionimin e rregullt, të sigurt dhe të aksesueshëm të tregjeve për qytetarët, fermerët dhe subjektet tregtare.

Ky funksion buron nga kompetencat e bashkive të përcaktuara në Ligji nr. 139/2015, i cili i ngarkon njësitë e vetëqeverisjes vendore me përgjegjësinë për administrimin e hapësirave publike dhe zhvillimin ekonomik lokal, përfshirë tregjet dhe aktivitetet tregtare në territor. Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së tregjeve, si dhe për rregullimin e aktivitetit tregtar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në praktikë, administrimi i tregjeve përfshin:

- Menaxhimin e infrastrukturës fizike (sipërfaqe, tezga, furnizim me ujë, energji, kanalizime, kushte higjieno-sanitare);
- Organizimin e aktivitetit tregtar (ndarja e hapësirave, licencimi, funksionimi i tregjeve bujqësore dhe të gjësë së gjallë);
- Mbledhjen e të ardhurave vendore nga qiratë dhe tarifat;
- Kontrollin dhe inspektimin (higjienë, siguri ushqimore, respektim i rregullave);
- Mbështetjen e prodhuesve lokalë, përmes hapësirave të dedikuara dhe aktiviteteve promovuese;
- Sigurinë dhe standardet veterinare, veçanërisht në tregjet e gjësë së gjallë.

Në këtë kontekst, administrimi i tregjeve luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal, duke krijuar lidhje direkte ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve, duke formalizuar aktivitetin tregtar dhe duke kontribuar në rritjen e të ardhurave të bashkisë.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Administrimi i tregjeve në Bashkinë Cërrik paraqet një strukturë të konsoliduar dhe të qëndrueshme infrastrukturore, me 2 tregje publike bujqësore në funksion dhe me sipërfaqe totale prej 13,920 m², pa ndryshime ndërvite. Gjithashtu, 100% e tregjeve rezultojnë me infrastrukturë të plotë dhe në përputhje me dokumentet e planifikimit territorial (PPV/PDV), duke reflektuar një bazë të mirë fizike dhe ligjore për funksionimin e tyre.

Në aspektin operacional, evidentohet një stabilitet në aktivitetin e tregjeve, ku numri i inspektimeve (413 në vit) dhe masave administrative mbetet i pandryshuar, duke treguar vazhdimësi në kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit tregtar. Nga ana tjetër, numri i pikave të shitjes ka pësuar një ulje të lehtë (nga 254 në 250), ndërsa përdorimi i vendeve të shitjes nuk është i reflektuar në tregues, çka sugjeron nevojën për përmirësim të monitorimit të shfrytëzimit real të kapaciteteve.

Një zhvillim pozitiv është rritja e të ardhurave nga qiratë e tregjeve (nga 14,336 në 16,856 lekë/vit) dhe rritja e përfshirjes së prodhuesve lokalë (nga 5 në 6), si dhe zgjerimi i hapësirave të dedikuara për ta (nga 15.75% në 18.80%). Në të njëjtën kohë, ulja e ankesave (nga 2 në 0) reflekton përmirësim në cilësinë e

shërbimit dhe menaxhimin e tregjeve. Megjithatë, mungesa e eventeve të tipit "treg i fermerëve" dhe e të dhënave mbi vizitorët tregon një potencial të pashfrytëzuar në aktivizimin ekonomik dhe social të këtyre hapësirave.

Sa i përket tregjeve të gjësë së gjallë, funksionimi i tyre paraqitet i qëndrueshëm (1 treg funksional), me mbulim të plotë të kontrollit veterinar (100%) dhe me infrastrukturë minimale të garantuar. Megjithatë, evidentohet një rënie e ndjeshme e numrit të pjesëmarrësve (nga 1,165 në 863) dhe një ulje e lehtë e të ardhurave, duke reflektuar një tkurrje të aktivitetit në këtë segment. Gjithashtu, mungesa e një rregulloreje specifike për këto tregje mbetet një boshllëk institucional.

Përfundim

Administrimi i tregjeve në Bashkinë Cërrik paraqitet i qëndrueshëm në aspektin infrastrukturor dhe organizativ, me përmirësime në të ardhura dhe në përfshirjen e prodhuesve lokalë. Megjithatë, mbetet hapësirë për rritjen e përdorimit të kapaciteteve, aktivizimin ekonomik të tregjeve dhe forcimin e dimensionit rregullator, veçanërisht për tregjet e gjësë së gjallë, në mënyrë që ky sektor të kontribuojë më shumë në zhvillimin lokal dhe mbështetjen e fermerëve.

## A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Trend Symbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Numri total i tregjeve publike bujqesore | Numër | 2.00 | 2.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Sipërfaqja mesatare për treg publik bujqesor | m² / treg | 6960.00 | 6960.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Sipërfaqja totale e tregjeve publike bujqesore | m² | 13920.00 | 13920.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Përqindja e tregjeve bujqesore me infrastrukturë të plotë | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Numri i pikave të shitjes (tezgave) ne tregje bujqesore | Numër | 254.00 | 250.00 | -4.00 | ↓ | -0.02 | ● |
| Tregues | Përqindja e tregjeve bujqesore në përputhje me PPV/PDV | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Të ardhurat nga qiratë e tregjeve bujqesore | lek / vit | 14336.00 | 16856.00 | 2520.00 | ↑ | 0.18 | ● |
| Tregues | Numri i inspektimeve në tregje bujqesore | nr. / vit | 413.00 | 413.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Numri i masave administrative në tregje bujqesore | nr. / vit | 2.00 | 2.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Përqindja e tregjeve bujqesore me plan emergjence | % | 50.00 | 50.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Numri i prodhuesve lokalë që shesin në treg bujqesor | Numër | 5.00 | 6.00 | 1.00 | ↑ | 0.20 | ● |
| Tregues | Përqindja e hapësirave për prodhues lokalë ne tregje bujqesore | % | 15.75 | 18.80 | 3.05 | ↑ | 0.19 | ● |
| Tregues | Numri i eventeve "treg i fermerëve" / panaireve ne tregje bujqesore | nr. / vit | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Numri i vizitorëve në tregjet kryesore bujqesore | nr. / vit | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00 | ○ |
| Tregues | Numri i ankesave për tregjet bujqesore | nr. / vit | 2.00 | 0.00 | -2.00 | ↓ | -1.00 | ● |
| Tregues | Ekzistenca e rregullores së tregjeve bujqesore | 1/0 (po/jo) | 1.00 | 1.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Numri i tregjeve të gjësë së gjallë funksionale | Numër | 1.00 | 1.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Frekuenca e organizimit të tregjeve të gjësë së gjallë | Ditë | 53.00 | 52.00 | -1.00 | ↓ | -0.02 | ● |
| Tregues | Numri i tregtarëve / fermerëve pjesëmarrës në tregjeve të gjësë së gjallë | Numër | 1165.00 | 863.00 | -302.00 | ↓ | -0.26 | ● |
| Tregues | Mbulimi e tregjeve me kontroll veterinar | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Intensitetit i kontrolleve veterinare të kryera | Kontrolle / ditë tregu | 1.00 | 1.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Të ardhurat e bashkisë nga tregjet e gjësë së gjallë | Mije Lekë | 883.00 | 862.00 | -21.00 | ↓ | -0.02 | ● |
| Tregues | Ekzistenca e rregullores për administrimin e tregjeve të gjësë së gjallë | Po =1/Jo=0 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |
| Tregues | Mbulimi me infrastrukturës minimale për sigurinë dhe mirëqenien e kafshëve te tregjeve të gjësë së gjallë | % | 100.00 | 100.00 | 0.00 | → | 0.00 | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nëntregu es | | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00 | O |

**B) Shtojcë: Të dhënat burim**

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| EDT01 | Numri total i tregjeve bujqesore publike në territor | 3 | 3 | 3 | Numër |
| EDT02 | Sipërfaqja totale e tregjeve bujqesore ne $m^2$ | 2500 | 2500 | 2500 | $m^2$ |
| EDT03 | Numri i pikave të shitjes (tezga) në tregje bujqesore ne total | 254 | 250 | 2500 | Numër |
| EDT04 | Numri i vendeve të zëna në tregjet bujqesore (shumatorja per te gjitha tregjet) | 80 | 80 | 80 | Numër |
| EDT05 | Të ardhurat nga qiratë e tregjeve bujqesore (lekë/vit) | 807 | 807 | 807 | Mijë Leke |
| EDT06 | Numri i inspektimeve në tregje bujqesore (higjienë, siguri, taksa) | 30 | 30 | 30 | Numër |
| EDT07 | Numri total i masave administrative ne tregjet bujqesore (gjobë, paralajmërim) | 0 | 0 | 0 | Numër |
| EDT08 | Numri i tregjeve bujqesore me infrastrukturë të plotë (ujë, drita, kanalizim, WC) | 1 | 1 | 1 | Numër |
| EDT09 | Numri i prodhuesve lokalë të regjistruar në tregje bujqesore | 80 | 80 | 80 | Numër |
| EDT10 | Numri i hapësirave të rezervuara për prodhues lokalë ne tregje bujqesore | 80 | 80 | 80 | Numër |
| EDT11 | Numri i eventeve të tipit "treg i fermerëve" / "panair lokal" ne tregje bujqesore | 1 | 1 | 1 | Numër |
| EDT12 | Numri i vizitorëve në tregjet kryesore bujqesore (vlerësim/numërim) | 5000 | 5000 | 5000 | Numër |
| EDT13 | Numri i ankesave të regjistruara për tregjet bujqesore | 1 | 1 | 0 | Numër |
| EDT14 | Ekzistenca e rregullores së tregjeve (po/jo + data azhurnimit) | po | po | po | po |
| EDT15 | Numri i tregjeve bujqesore që janë në përputhje me PPV/PDV (po/jo) | 0 | 0 | 0 | Numër |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| EDT16 | Numri i tregjeve bujqesore që kanë plan emergjence (po/jo) | 0 | 0 | 0 | Numër |
| DGJ01 | Numri i tregjeve të gjësë së gjallë funksionale | 0 | 0 | 0 | Numër |
| DGJ02 | Numri i ditëve të organizimit të tregut në vit | 192 | 192 | 192 | Ditë |
| DGJ03 | Numri i tregtarëve/fermerëve pjesëmarrës në vit | 1800 | 1800 | 1800 | Numër |
| DGJ04 | Ekzistenca e kontrollit veterinar në tregjet e gjësë së gjallë | 0 | 0 | o | jo |
| DGJ05 | Numri i kontrolleve veterinare të kryera në vit | 0 | 0 | 0 | jo |
| DGJ06 | Të ardhurat vjetore nga tarifat e tregut | 2075610 | 2075610 | 1806710 | Mije Leke |
| DGJ07 | Ekzistenca e rregullores për tregjet e gjësë së gjallë | 0 | 0 | o | jo |
| DGJ08 | Numri I tregjeve te gjese se gjalle me nivel te infrastrukturës minimale funksionale | 0 | 0 | 0 | Numer |

# Mbeshtetje biznesi

Shërbimi i **Mbështetjes së Biznesit dhe Zhvillimit Ekonomik** përfaqëson një nga funksionet kryesore të bashkisë në kuadër të zhvillimit vendor, i cili synon **nxitjen e aktivitetit ekonomik, përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e punësimit në territor**.

Ky shërbim, sipas logjikës së regjistrit të shërbimeve, buron nga përgjegjësitë e përcaktuara në Ligji nr. 139/2015, si dhe nga dokumentet strategjike të zhvillimit vendor (PPV, strategji zhvillimi ekonomik, plane sektoriale), duke u lidhur drejtpërdrejt me funksionin e **zhvillimit ekonomik lokal**.

Në kuadër të regjistrit të shërbimit, mbështetja e biznesit dhe zhvillimi ekonomik përfshin disa nënkomponentë kryesorë:

- **Monitorimi i aktivitetit ekonomik në territor**, përmes treguesve si numri i bizneseve aktive, hapjet dhe mbylljet;
- **Mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)**, përmes informimit, trajnimeve dhe ndërmjetësimit në skema financimi;
- **Nxitja e investimeve dhe bashkëpunimit me sektorin privat**, përfshirë marrëveshje bashkëpunimi dhe asistencë për investitorët;
- **Zhvillimi i sektorëve prioritarë**, si agropërpunimi dhe turizmi;
- **Promovimi i territorit dhe i produkteve vendore**, përmes eventeve, materialeve promocionale dhe rrjeteve të bashkëpunimit;

- **Mbështetja e inovacionit dhe sipërmarrjes së re**, përfshirë startup-et dhe iniciativat e reja ekonomike.

Në këtë kuptim, ky shërbim funksionon si një **mekanizëm lidhës ndërmjet bashkisë, biznesit dhe komunitetit**, duke synuar jo vetëm administrimin e aktivitetit ekzistues ekonomik, por edhe krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe konkurrueshmëri të territorit.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve

Zhvillimi ekonomik në Bashkinë Cërrik paraqet një trend pozitiv në zgjerimin e aktivitetit sipërmarrës, i reflektuar në rritjen e numrit të bizneseve aktive (nga 608 në 693) dhe të bizneseve të reja (nga 38 në 42). Në të njëjtën kohë, norma e mbylljes së bizneseve ka rënë ndjeshëm (nga 5.26% në 0.72%), duke treguar një stabilitet më të madh të tregut dhe një mjedis më të favorshëm për biznesin.

Në aspektin e mbështetjes institucionale, bashkia ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm të asistencës për NVM-të, me sesione informimi të pandryshuara (2 në vit), por me rritje të pjesëmarrjes në trajnime (nga 35 në 41). Gjithashtu, evidentohet një rritje e aplikimeve dhe përfitimeve nga skemat kombëtare, si dhe një zhvillim pozitiv në marrëveshjet bashki–biznes (nga 0 në 2). Megjithatë, mungesa e mbështetjes për startup-et dhe e integrimit të bizneseve në zinxhirë vlere tregon një potencial ende të pashfrytëzuar në këtë drejtim.

Nga ana e investimeve, sektori paraqet një rritje të dukshme të investimeve të reja, si në numër (nga 9 në 11) ashtu edhe në vlerë (nga 487,500 në 576,800 mijë lekë), duke reflektuar një rritje të besimit dhe aktivitetit ekonomik në territor. Paralelisht, sektori i turizmit vijon një zhvillim pozitiv, me rritje të turistëve të huaj (nga 2,824 në 3,270), vizitorëve ditorë dhe përdorimit të kapaciteteve akomoduese (raporti turistë/shtretër nga 62.76 në 72.67). Gjithashtu, janë shtuar atraksionet turistike dhe aktivitetet promocionale, duke kontribuar në rritjen e vizibilitetit të territorit.

Përfundim

Zhvillimi ekonomik në Bashkinë Cërrik paraqet një trend pozitiv dhe të qëndrueshëm, me rritje të biznesit, investimeve dhe aktivitetit turistik. Megjithatë, për të konsoliduar këtë zhvillim, mbetet e rëndësishme forcimi i mbështetjes për startup-et, integrimi i bizneseve në zinxhirë vlere dhe zgjerimi i rolit aktiv të bashkisë në nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal.

## A) Lista e detajuar

| Lloj | Emri | Njësia Matëse | 2024 | 2025 | Trendi | Trend Symbol | % Ndryshimi | Semafor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Numri i bizneseve aktive | Numër | 608.00 | 693.00 | 85.00 | ↑ | 0.14 | ● |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Numri i bizneseve të reja | Numër | 38.00 | 42.00 | 4.00 | ↑ | 0.11 | |
| Tregues | Norma e krijimit të bizneseve | % | 6.25 | 6.06 | -0.19 | ↓ | -0.03 | |
| Tregues | Norma e mbylljes së bizneseve | % | 5.26 | 0.72 | -4.54 | ↓ | -0.86 | |
| Tregues | Pesha e bizneseve të drejtuara nga gra | % | 21.22 | 18.90 | -2.31 | ↓ | -0.11 | |
| Tregues | Pesha e bizneseve / agro përpunuese & turizmit | % | 3.45 | 3.75 | 0.30 | ↑ | 0.09 | |
| Tregues | Pesha e NVM-ve të asistuara nga bashkia | % | 6.25 | 6.06 | -0.19 | ↓ | -0.03 | |
| Tregues | Numri i sesioneve të informimit/këshillimit për bizneset | Numër | 2.00 | 2.00 | 0.00 | → | 0.00 | |
| Tregues | Numri i pjesëmarrësve në sesione dhe trajnime ekonomike | Numër | 35.00 | 41.00 | 6.00 | ↑ | 0.17 | |
| Tregues | Numri i startup-eve të mbështetura (grant/inkubim) | Numër | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00 | |
| Tregues | Pesha e startup-eve të mbështetura | % | -1.#J | -1.#J | -1.#J | ↓ | -1.#J | |
| Tregues | Numri i investimeve të reja në territor | Numër | 9.00 | 11.00 | 2.00 | ↑ | 0.22 | |
| Tregues | Vlera e investimeve të reja | Mijë lekë | 48750<br>0.00 | 57680<br>0.00 | 89300.<br>00 | ↑ | 0.18 | |
| Tregues | Numri i investimeve në zonat ekonomike | Numër | 9.00 | 11.00 | 2.00 | ↑ | 0.22 | |
| Tregues | Numri i NVM-ve të integruara në zinxhirë vlere / konsorciume | Numër | 0.00 | 0.00 | 0.00 | → | 0.00 | |
| Tregues | Numri i marrëveshjeve MoU bashki–biznes | Numër | 0.00 | 2.00 | 2.00 | ↑ | 0.00 | |
| Tregues | Numri i turistëve të huaj | Numër | 2824.<br>00 | 3270.<br>00 | 446.00 | ↑ | 0.16 | |
| Tregues | Numri i vizitorëve ditorë | Numër | 3785.<br>00 | 4125.<br>00 | 340.00 | ↑ | 0.09 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregues | Netë-qëndrime në territor | Numër | 2.00 | 2.00 | 0.00 | → | 0.00 |
| Tregues | Numri i strukturave akomoduese | Numër | 7.00 | 7.00 | 0.00 | → | 0.00 |
| Tregues | Numri i shtretërve në struktura akomoduese | Numër | 45.00 | 45.00 | 0.00 | → | 0.00 |
| Tregues | Turistë për shtretër (raport i ngarkesës) | turistë/shtretër | 62.76 | 72.67 | 9.91 | ↑ | 0.16 |
| Tregues | Numri i atraksioneve të inventarizuara | Numër | 6.00 | 8.00 | 2.00 | ↑ | 0.33 |
| Tregues | Numri i operatorëve turistikë/guideve në territor | Numër | 5.00 | 5.00 | 0.00 | → | 0.00 |
| Tregues | Numri i qendrave të informacionit turistik (TIC) | Numër | 3.00 | 3.00 | 0.00 | → | 0.00 |
| Tregues | Numri i vizitorëve në qendrat TIC | Numër | 234.00 | 325.00 | 91.00 | ↑ | 0.39 |
| Tregues | Numri i eventeve kulturore/turistike | Numër | 4.00 | 5.00 | 1.00 | ↑ | 0.25 |
| Tregues | Numri i materialeve promocionale (broshura, fushata, web, etj.) | Numër | 1.00 | 2.00 | 1.00 | ↑ | 1.00 |
| Nëntregues | | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | | 0.00 |

| Kodi I të dhënës | E dhëna | Vlera 2023 | Vlera 2024 | Vlera 2025 | Njësia Matëse |
|---|---|---|---|---|---|
| EDB01 | Numri i bizneseve aktive në territor | 592 | 608 | 693 | Numër |
| EDB02 | Numri i bizneseve të reja të regjistruara (në vit) | 35 | 38 | 42 | Numër |
| EDB03 | Numri i bizneseve të mbyllura (në vit) | 82 | 32 | 5 | Numër |
| EDB04 | Numri i bizneseve të drejtuara nga gra | 141 | 129 | 131 | Numër |
| EDB05 | Numri i bizneseve / agropërpunuese & turizmit | 19 | 21 | 26 | Numër |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| EDB06 | Numri i NVM-ve të asistuara nga bashkia (këshillim, shërbim) | 35 | 38 | 42 | Numër |
| EDB07 | Numri i sesioneve të informimit/këshillimit për biznes | 1 | 2 | 2 | Numër |
| EDB08 | Numri i pjesëmarrësve në trajnime ekonomike | 33 | 35 | 41 | Numër |
| EDB09 | Numri i startup-eve të regjistruara në territor | 0 | 0 | 0 | Numër |
| EDB10 | Numri i startup-eve të mbështetura (grant, inkubim, mentorim) | 0 | 0 | 0 | Numër |
| EDB11 | Numri i aplikimeve të bizneseve në skemat kombëtare (Fondi NVM, garanci, grante) | 2 | 4 | 6 | Numër |
| EDB12 | Numri i përfituesve të granteve/garancive në territor | 2 | 4 | 5 | Numër |
| EDB13 | Numri i investimeve të reja të identifikuara në territor | 7 | 9 | 11 | Numër |
| EDB14 | Vlera e investimeve të reja (EUR) | 350000 | 487500 | 576800 | Mijë Lekë |
| EDB15 | Numri i investitorëve të asistuar (after-care) | 7 | 9 | 11 | Numër |
| EDB16 | Numri i lejeve të zhvillimit në zonat ekonomike | 7 | 9 | 11 | Numër |
| EDB17 | Numri i marrëveshjeve MoU të nënshkruara me biznese/org. biznesi | 0 | 0 | 2 | Numër |
| EDB18 | Numri i NVM-ve të përfshira në zinxhirë vlere (klastere, konsorciume) | 0 | 0 | 0 | Numër |
| EDTUR01 | Numri i turistëve të huaj (në qark/bashki) | 2432 | 2824 | 3270 | Numër |
| EDTUR02 | Numri i vizitorëve ditorë | 3200 | 3785 | 4125 | Numër |
| EDTUR03 | Numri i netë-qëndrimeve | 2 | 2 | 2 | Numër |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| EDTUR04 | Numri i strukturave akomoduese (hotele, B&B, bujtina) | 6 | 7 | 7 | Numër |
| EDTUR05 | Numri i shtretërve në struktura akomoduese | 38 | 45 | 45 | Numër |
| EDTUR06 | ADR, RevPAR, norma e okupancës | 64 | 62 | 72 | Numër |
| EDTUR07 | Numri i atraksioneve turistike të inventarizuara | 5 | 6 | 8 | Numër |
| EDTUR08 | Numri i operatorëve turistikë/guideve të licencuar në territor | 3 | 5 | 5 | Numër |
| EDTUR09 | Numri i qendrave të informacionit turistik (TIC) | 2 | 3 | 3 | Numër |
| EDTUR10 | Numri i vizitorëve në qendrat TIC | 175 | 234 | 325 | Numër |
| EDTUR11 | Numri i eventeve kulturore/turistike në vit | 3 | 4 | 5 | Numër |
| EDTUR12 | Numri i materialeve promocionale (broshura, faqe web, fushata) | 1 | 1 | 2 | Numër |

Punoi:

Erinda Toska

Hekuran Kumria

Erjola Calja

Miratoi:

Kryetari I bashkise Cerrik

Florenc Doka